



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 336 Prot.

Tiranë, më dt. 05.09.2017

VENDIM

Nr.248, dt. 05.09.2017

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 05.09.2017, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit ndërtimi i HEC “ZEKA” dhe “ZAIS”, në lumin e Urakës dhe përroin e Melthit, Bashkia Mat dhe Mirditë, nga shoqëria “SEKA Hydropower” sh.p.k.
2. Shoqëria të kontribuojë për objektin monument kulture me projekt: “Pastrim nga bimësa, sinjalistika me tabela informuese dhe ndriçimi për shpellat e Nezirit dhe të Blazit në bashkinë Mat”
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR I DELEGUAR
ARTA DOLLANI